



Dëshmi për njohuri gjuhësore në rast aplikimi për vizë

Gjatë aplikimit për vizë për një tërësi qëllimesh të ndryshme (ndër të tjera për të heqjen e bashkëshortit/es, të fëmijës nisur nga 16 vjec, punësim në profesione të mjekësisë, Au-Pair) aplikuesit duhet të dëshmojnë zotërimin e **njohurive të gjermanishtes** në nivelin përkatës sipas Kuadrit të Përgjithshëm Evropian të Referencave. Se cili nivel kërkohet për një qëllim të caktuar qëndrimi, për këtë lexoni fletët përkatëse të informacionit. Informacione të mëtejshme rreth përmbajtjes dhe nivelit të provimit në nivele të ndryshme gjuhësore mund të gjeni ndër të tjera edhe në faqen e internetit <https://www.goethe.al/>.

Si dëshmi e njohurive të gjuhës duhet të paraqitet certifikata e një provimi gjuhësor, e cila është lëshuar pas dhënies së një provimi gjuhësor të standardizuar sipas **Standards der „Association of Language Testers in Europe (ALTE)“**.

Gjatë aplikimit për vizë pranë Ambasadës Gjermane në Tiranë aktualisht njihen **certifikatat gjuhësore të ofruesve të mëposhtëm:**

- Goethe-Institut e.V. (GI),
- Verein Österreichisches Sprachdiplom Deutsch (ÖSD),
- TestDaF-Institut (TestDaF),
- telc gGmbH (TELC)

Të gjitha certifikatat apo vërtetimet e shkollave të tjera gjuhësore, që vetëm sa konfirmojnë pjesëmarrjen në kurset e gjermanishtes, nuk mund të konsiderohen si të vlefshme në procedurat për vizë.

Po kështu **nuk njihen certifikatat gjuhësore të pjeshme** të moduleve / aftësive gjuhësore të vecanta „Të folurit, të shkruarit, lexim, dëgjim“, por **vetëm certifikata të provimeve gjuhësore që përmbajnë të katër modulet / aftësitë**.

Lutemi të mbani në konsideratë që **ditën e aplikimit për vizë** certifikata gjuhësore dhe provimet e përmbajtura në të të katër moduleve / aftësive duhet të jenë në atë nivel që kërkohet për qëllimin e qëndrimit tuaj dhe **jo më të hershme se 1 vit**. Certifikata më të vjetra gjuhësore dhe ato me module të pjeshme më të vjetra nuk mund të konsiderohen të vlefshme.

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.